



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE**

Nr. 1965/2 Prot.

Tiranë, më 11.10.2022

V E N D I M

Nr. 25/ datë. 11.10.2022

PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË ZNJ ETMONDA HOXHA NË VENDIN VAKANT PËR INSPEKTOR JO MAGJISTRAT, SHPALLUR NGA INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NË DATËN 30.09.2021.

Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i përbërë nga:

Z. Besnik Maho - Kryetar

Znj. Joana Asimi – Anëtar

Z. Julian Zonja - Anëtar

Asistuar nga Sekretariati teknik i përbërë nga:

Znj. Alma Zili

Znj. Eljona Bylykbashi

Znj. Jetmira Saraçi

Në mbledhjen e datës 10.10.2022, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve mori në shqyrtim çështjen që i përket:

Kandidatit inspektor jomagjistrat

Znj. ETMONDA HOXHA

OBJEKTI:

Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së Znj. Etmonda Hoxha në vendin vakant për Inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021.

KOMITETI PASI :

U njoh me aktet si edhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, pikës 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit", urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", me njoftimin e datës 30.09.2021, në faqen zyrtare ka shpallur procedurën për 9 vende vakante për pozicionin e inspektorit jomagjistratë. Shpallja ka qenë e hapur për 30 ditë, periudhë gjatë së cilës do të administrohet kërkesa e të interesuarve, bashkë me dokumentacionin e renditur në shpallje.
2. Në përfundim të afatit të shpalljes, me urdhrin nr. 142, datë 29.10.2021 "Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e Inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka ngritur Komitetin e Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, si organi që do të zhvillojë procedurat përzgjedhëse për plotësimin e vendeve të shpallura.
3. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, në përfundim të afatit për paraqitjen e aplikimeve për shprehje interesi për kandidim datë 29.10.2021, zhvilloi mbledhjen e parë më datë 08.11.2021, ku vendosi për radhën e shqyrtimit të dosjes që i përket çdo kandidati dhe fillimin e procedurave/zhvillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendin vakant për Inspektor jomagjistratë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke njoftuar në faqen zyrtare në rubrikën "Njoftime"; "Rekrutim Inspektorë Jo-Magjistratë" listën e personave të interesuar për vendin vakant dhe fillimin e shqyrtimit të aplikimeve të kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 209 dhe nenin 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të

kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”.

4. Në zbatim të nenit 209 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të pikës 27, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komiteti i Emërimeve dhe Vlerësimit të Inspektorëve, pasi zhvilloi procedurat e verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore për pozicionin e inspektorit, në mbledhjen e datës 07.07.2022, vendosi lejimin e kandidimit për pozicionin e inspektorit jomagjistrat për Znj. Etmonda Hoxha dhe me komunikimin e datës 14.09.2022, njoftoi kandidatët për fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve.
5. Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve me vendimin nr.25, datë 07.07.2022 ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatit Etmonda Hoxha për Inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 209 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, duke u bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidati në momentin e kandidimit dhe gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, hartoi relacionin e vlerësimit të këtij kandidati.
6. Sipas kalendarit të intervistave të miratuar, në 21.09.2022 dhe 22.09.2022, ka zhvilluar procedurën e intervistës me kandidatët e lejuar, mbi motivimin e kandidimit, për 9 (nëntë) vendet vakante.
7. Intervista mbi motivimin e kandidimit, Znj. Etmonda Hoxha, kandidati për të 9 (nëntë) vendet vakante në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, u zhvillua në datën 21.09.2022.

II. Vlerësimi i Komitetit

8. . Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidimit, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidati në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumente të paraqitura prej tij sipas kërkesave të Komitetit, si edhe shkresa dhe të dhëna të tjera kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme, Komiteti ka vënë në bisedim vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit Etmonda Hoxha për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara në shpjegimet e hollësishme të metodologjisë mbi të cilën bazohet vlerësimi dhe pikëzimi, miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përkatësisht:

1. Meritat profesionale - (50) pikë

A. Historiku Arsimor dhe Profesional - (10) pikë

9. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Etmonda Hoxha, disponon këto të dhëna:
- Sekretar i seancës gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan për periudhën 09 Janar 2003-12 Korrik 2005;
 - Jurist, Përgjegjës Sektori Juridik I.E.V.P Peqin për periudhën 12 Korrik 2005-04 Shtator 2009;
 - Përgjegjës i Sektorit Ligjor, I.E.V.P Rrogozhinë për periudhën 04 Shtator 2009-01 Prill 2010;
 - Përgjegjës i Sektorit Ligjor, I.E.V.P Peqin për periudhën 01 Prill 2010 - 10 Qershor 2010;
 - Specialist Jurist në Sektorin Ligjor, I.E.V.P Peqin për periudhën 10 Qershor 2010-07 Shtator 2011;
 - Specialist Audit, KLD për periudhën 12 Shtator 2011-09 Janar 2013;
 - Jurist Part-Time pranë firmës Progress Sh.p.k 04 Janar 2013-25 Janar 2016;
 - Specialist me kontrate, Aluizni Tiranë për periudhën 17 Shkurt 2017-31 Dhjetor 2017;
 - Specialist me kontrate, Aluizni Zonat Turistike për periudhën 05 Qershor 2018-05 Shtator 2018;
 - Specialist i Sekretarisë Gjyqësore, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për periudhën 21 Janar 2019 -deri në datën e paraqitjes së aplikimit.

a. Historiku Arsimor (2) pikë

10. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe ecuria gjatë kryerjes së **arsimit të lartë juridik** me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, ndërkohë që edhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, kërkon të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.
11. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Etmonda Hoxha ;
- Ka përfunduar Fakulteti i Shkencave Humane dega Juridik, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan në periudhën 2001 duke u diplomuar “*Jurist*”. Sipas certifikatës së notave të lëshuar nga Fakulteti i Shkencave Humane dega Juridik, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, rezulton se ka përfunduar studimet universitare me notë mesatare 8.1
12. Prandaj, Komiteti vlerëson me pikë ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të secilin kandidat, sipas përshkallëzimit me 1 pikë të notës mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë të notës mesatare mbi 9, sikurse orientohet në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve.
13. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “historiku arsimor”, nisur nga nota mesatare 8.1, e arritur gjatë studimeve dhe diplomimit në Fakultetin e Shkencave Humane dega Juridik, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Komitetit çmoi ta vlerësojë kandidatin **Etmonda Hoxha me 1 (një) pikë.**

b. Kualifikime Pasuniversitare - (5) pikë

b.1 Studimet pasuniversitare - (1/5) pikë

14. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe mbajtja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.

15. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve, si edhe orientimet që përmbahen në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për inspektor jomagjistrat.
16. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Etmonda Hoxha të këtë ndjekur studime pasuniversitare, përgjatë **periudhës 2010-18.02.2013**, MND në fushën e Legjislacionit dhe Institucioneve Evropiane, pranë Instituti i Studimeve Evropiane pranë Universitetit të Tiranës, ku dhe është diplomuar. Lidhur me këtë kriter, diploma e fituar, është e barasvlershme me atë të një studimi pasuniversitar të ciklit të tretë të studimeve, referuar ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nisur nga kohëzgjatja dhe numrit i krediteve të fituara.
17. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “**Kualifikime Pasuniversitare**”, që lidhet me studimet pasuniversitare, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin Etmonda Hoxha me **1 (një) pikë**.

b.2 Gradat shkencore - (3/5) pikë

18. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe mbajtja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.
19. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve, si edhe orientimet që përmbahen në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për inspektor jomagjistrat.
20. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, nuk rezulton

që kandidati Etmonda Hoxha të këtë fituar brenda ose jashtë vendit grada shkencore në bazë të nenit 60, 61 dhe 79 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, (Dr, Phd, Prof apo Pro/asoc, Magjistraturë, etj).

21. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “**Kualifikime Pasuniversitare**”, që lidhet me gradat dhe kërkimin shkencor, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin Etmonda Hoxha me **0 (zero) pikë**.

b.3. Lista dhe lloji i trajnimeve - (1/5) pikë

22. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidati Etmonda Hoxha ka ndjekur disa veprimtari trajnimi afatshkurtra të dokumentuara, konkretisht:
- 16-17 nëntor viti 2012, certifikate roli im ka qenë si pjesëmarrëse, ky trajnim është organizuar nga Qendra Kombëtare e Trajnimit për Ndërmjetësimin Tregtar të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë CCEP-ZMK me temë “ Ndërmjetësimi tregtar”.
 - 9-10 nëntor viti 2012 , certifikatë roli im ka qene si pjesëmarrëse në trajnimin e organizuar nga Qendra Kombëtare e Trajnimit për Ndërmjetësimin Tregtar të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë CCEP-ZMK me temë “Këshilla të psikologjisë sociale në ndërmjetësim”.
 - Datë 31 tetor viti 2012 certifikatë , roli im ka qene si pjesëmarrëse ne seminarin me temë “ Gjurma e Auditit”, zhvilluar nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike.
 - Datë 22-23 Tetor viti 2012 certifikate si pjesëmarrëse në trajnimin e organizuar nga Qendra Kombëtare e Trajnimit për Ndërmjetësimin Tregtar të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë CCEP-ZMK me temë “ Marrëdhëniet konsumator biznes në ndërmjetësimin tregtar”.
 - Datë 16-17 tetor viti 2012 certifikate si pjesëmarrëse në trajnimin e zhvilluar nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike zhvillohet seminari me temë “ Hartimi i shkresave zyrtare dhe komunikimi”.
 - Datë 8-9 Tetor viti 2012 certifikate si pjesëmarrëse trajnim organizuar nga Qendra Kombëtare e Trajnimit për Ndërmjetësimin Tregtar të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë CCEP-ZMK me temë “ Ndërmjetësimi në çështjet tregtare e qytetare”.
 - Datë 12-13 Korrik viti 2012 certifikate pjesëmarrëse në trajnimin e organizuar nga Qendra Kombëtare e Trajnimit për Ndërmjetësimin Tregtar të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë CCEP-ZMK me temë “ Marrëdhëniet midis palëve dhe aftësitë e komunikimit në ndërmjetës”.
 - Datë 29-30 qershor viti 2012 certifikate si pjesëmarrëse në trajnimin e organizuar nga Qendra Kombëtare e Trajnimit për Ndërmjetësimin Tregtar të Dhomës së Tregtisë dhe

Industrië Tiranë CCEP-ZMK me temë “ Teknikat e ndërmjetësimit”, i zhvilluar në ambientet e Dhomës Kombëtare së Tregtisë dhe Industrië Tiranë

- Datë 13-14 qershor viti 2012 certifikate si pjesëmarrëse në trajnimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës me temë “ Trajnimi specifik i inspektorëve të KLD, me funksione-inspektimi dhe vlerësimi.
- Datë 2-15 Maj 2017 certifikatë si pjesëmarrëse në trajnimin “Prokurimi Publik” organizuar nga Shkolla e Administratës Publike.
- Datë 15-16 mars viti 2012 certifikate si pjesëmarrëse në trajnimin me temë “Etika dhe antikorrupsioni”, zhvilluar nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike.
- Datë 31 Tetor 2012 certifikatë si pjesëmarrëse në trajnimin me temë “Gjurma e Auditimit” organizuar nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike.
- Viti 2009 pjesëmarrëse dhe referuese në seminarin trajnues –implementimi i projektit “Program aktivitetesh dhe masash për riintegrimin e personave me liri të kufizuar, Zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme Burgjeve Tiranë,
- Viti 2008 pjesëmarrëse dhe referuese në seminarin trajnues të zhvilluar nga projekti AECID organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë & OJQ Spanjolle
- Viti 2004 pjesëmarrëse në trajnimin e zhvilluar nga Qendra e Aleancës Gjimore –“Mbi trajnimin dhe zbatimin e të drejtave të grave në Shqipëri, konkretisht ky trajnim është zhvilluar në ambientet e Qendrës së Gruas Elbasan mbrapa Gjykatës së Vjetër Elbasan.
- Viti 2006-2007 pjesëmarrëse referuese në kurse trajnimi të vazhdueshme për juristët e I.E.V.P-vetë organizuar nga D.P.B Tiranë në kuadër të trajnimit dhe të respektimit të të drejtave dhe detyrimeve të të dënuarve në Republikën e Shqipërisë.

23. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “**Kualifikime Pasuniversitare**”, që lidhet me trajnimet, Komiteti çmon ta vlerësojë kandidatin Etmonda Hoxha me **1 (një) pikë**.

c. Njohja e gjuhëve të huaja - (3) pikë

24. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezulton se kandidati ka vetëdeklaruar në jetëshkrim se është njohës i gjuhës angleze, e faktuar me dëshminë e lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, **me notën 8 (tetë)**. Rezulton se përveç dëshmisë të gjuhës angleze kandidati Etmonda Hoxha, nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi të gjuhëve të tjera të huaja apo certifikata të kurseve të gjuhëve të huaja të zhvilluar.

25. Për këto arsye, duke pasur parasysh dokumentacionin e administruar, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin Etmonda Hoxha për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **1 (një) pikë**.

B. Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional - (30) pikë

26. Referuar shtojcës nr.2, të urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe kualifikimi i **përgjithshëm profesional**, përcaktohen si kriter vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse.
27. Prandaj, në zbatim të ligjit, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen parasysh sasia e pikëve maksimale **prej 30 pikësh** sipas urdhrit nr. 7 referuar si më sipër, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të **një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin** dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor jomagjistrat.
28. Në rastin e kandidatit Etmonda Hoxha, Komiteti shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e tij profesionale ndër vite, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të këtij kandidati në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë.

a. Vlerësimi sasior - (5) pikë

29. Për sa i përket **vlerësimit sasior**, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi, rezulton se në dosjen e kandidimit është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm që ka të bëjë me aktivitetin profesional, kërkimin shkencor dhe publikimet nga ana e kandidatit znj. Etmonda Hoxha:
- Platformë ku është prezantuar të gjitha cilësitë etik-profesionale të kandidates në pozicionin e punës si Komisioner për KPK (20 faqe).
30. Mbështetur në këto të dhëna të rezultateve në ushtrimin e detyrës, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të lidhura me ushtrimin e detyrës apo edhe me ushtrimin e profesionit, Komiteti vlerëson se në aspektin sasior, nga 5 (pesë), akte që duhet të paraqesë

çdo kandidat, rezulton se znj. Etmonda Hoxha, përtej eksperiencës të saj të punës të pasqyruara në CV, dhe asaj të deklaruar në intervistën e zhvilluar para Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, nuk ka dorëzuar mjaftueshëm akte procedurale, veprime juridike, apo çdo lloj dokumenti tjetër që nxjerr në pah angazhimin e saj profesional, në ushtrimin e profesionit dhe funksionit që ajo ka përmbushur si subjekt privat apo si pjesë e stafit të administratës administrative dhe asaj gjyqësore. Për këto arsye, Komiteti çmoi ta vlerësojë kandidatin Etmonda Hoxha për këtë kriter ligjor vlerësimi me **2 (dy) pikë.**

b. Vlerësim cilësor - (25) pikë

31. Për sa i përket **vlerësimit cilësor**, Komiteti shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej tij, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionale dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatis dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e tij në kuptimin dhe qëllimin për të cilin ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Komitet dhe, më tej, për përzgjedhjen e Inspektorit jomagjistrat.
32. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, kandidati **Etmonda Hoxha**, për qëllimet e procedurës së vlerësimit në kuadër të pikëzimit për “Kualifikimin e Përgjithshëm Profesional” dhe “Kualifikimin Shtesë Profesional”, ka paraqitur nga **pesë dokumentet profesionale që kërkohen në lidhje e këtë kriter, vetëm** Platformën ku është prezantuar të gjitha cilësitë etik-profesionale të kandidates në pozicionin e punës si Komisioner për KPK (20 faqe).
33. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidati **Etmonda Hoxha** dhe, në veçanti, lidhur me pesë dokumentet profesionale të sipërcituara, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi, Komiteti shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e Platformës të paraqitur nga kandidatja lidhur me cilësitë etik-profesionale, si kandidate në pozicionin e punës si Komisioner për KPK, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë orientime që përmbahen në metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor.(shtojca nr.2).
34. Dokumentet trajtojnë tematika në fushën e së drejtës në të cilën ka operuar ndër vite kandidati, përfshi ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ligjshmërisë së veprimtarisë administrative të organeve shtetërore, mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material e procedural në përmbushjen e detyrimeve të organit shtetëror si edhe të subjekteve dhe individëve në raport

me të drejtat dhe detyrimet **përkundrejt organit shtetëror kompetent**. Në Platformën që ka depozituar kandidati znj. Etmonda Hoxha, në kuadrin e vlerësimit etik dhe profesional, ku ajo ka kandiduar në pozicionin e punës si Komisioner në KPK, spikat aftësia profesionale e kandidatit për të përgatitura akte procedurale sikurse janë kërkesë-padia, parashtrime, konkluzione dhe opinione që lidhen me ndryshimet e akteve ligjore, në funksionet që ai ka pasur si sekretare gjyqësore në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Elbasan, juriste në I.E.V.P Peqin, përfaqësuese dhe mbrojtëse e të drejtave dhe lirive të subjekteve të së drejtës (qytetarë/persona juridikë) në sektorin privat dhe specialiste pranë ish KLD-së. Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe Platforma e paraqitur nga vetë kandidati znj. Etmonda Hoxha, për sa më sipër si dhe intervista e zhvilluara me të nga ana e Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, vlerësimi i këtyre të dhënave bëhet në pesë komponentë kryesorë që janë, origjinaliteti dhe/ose impakti i veprimtarisë profesionale të kandidatit, aftësitë analitike, aftësitë kërkimore, saktësia dhe precizioni, si dhe qartësia.

b/1. Origjinalitet dhe/ose impakti - (6) pikë

35. Njëri nga indikatorët vlerësues të dokumenteve profesional është vlerësues të dokumenteve profesionalë është **“Origjinaliteti dhe/ose impakti”**. Nisur nga profili profesional i kandidatit Etmonda Hoxha, përmbajtja e Platformës që ajo ka dorëzuar si dhe intervistën e zhvilluar para Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, rezulton se dokumentacioni i paraqitur ofron një panoramë të elementëve të një qasje profesionale origjinale në trajtimin e çështjeve ligjore të trajtuara para organeve gjyqësore, institucioneve të vuajtjes të dënimeve lidhur me liritë dhe të drejtat e personave me heqje të lirisë (*burgim*), trajtimin paraprak të ankesave në ish KLD si dhe përgatitjen e akteve të ndryshme procedurale si person fizik (avokate/përfaqësuese e subjekteve privatë).
36. Për rrjedhojë pas shqyrtimit të dokumentacionit, në zërin **“Origjinaliteti dhe impakti”**, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.

b/2. Aftësitë analitike - (6) pikë

Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me **“Aftësitë analitike”**, Komiteti duke u bazuar në dokumentacionin e depozituar në dosjen e kandidimit si dhe intervistën e zhvilluar me kandidatin znj. Etmonda Hoxha, arrin në konkluzionin se zotëron aftësi të mira profesionale, për të arsyetuar dhe zbatuar konceptet ligjore në fushën e operimit.

37. Për rrjedhojë , pas shqyrtimit të analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me zërin **“Aftësitë analitike”**, Komiteti vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.

b/3. Aftësitë kërkimore - (4) pikë

38. Në lidhje me treguesin “**Aftësitë kërkimore**”, Komiteti shqyrtoi dokumentacionin profesional të paraqitur nga kandidati.
39. Pas shqyrtimit të dokumentacionin e dorëzuar nga znj. Etmonda Hoxha në dosjen e kandidimit, në lidhje me treguesin “Aftësitë kërkimore”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **2 (dy) pikë**.

b/4. Saktësia dhe precizioni - (5) pikë

40. Referuar kriterit “**Saktësia dhe precizioni**”, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët kanë mbuluar me profesionalizëm tematikën e përzgjedhur duke shmangur përsëritjet në material. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, për aq sa është e mundur nga lloji i dokumentacionit, Komiteti vëren nivel të mjaftueshëm të përcaktimit të tematikës dhe problemeve juridike.
41. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “**Saktësia dhe precizioni**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **3 (tre) pikë**.

b/5. Qartësia - (4) pikë

42. Referuar kriterit “**Qartësia**”, në thelb verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët e kanë strukturuar tematikën dhe problemin duke qartësuar gjuhën dhe duke përdorur në mënyrë të kënaqshme terminologjinë profesionale. Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, për aq sa është e mundur nga lloji i dokumentacionit, si dhe intervista e zhvilluar me kandidatin, Komiteti vëren nivel të mirë të parashtrimeve dhe qëndrimit që ai ka në lidhje me veprimtarinë e ILD-së.
43. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me treguesin “**Qartësia**”, Komiteti e vlerëson kandidatin **2 (dy) pikë**.
44. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, që përbëjnë **vlerësimin cilësor** të kandidatit, Komiteti vendosi të vlerësojë kandidatin me **13 (trembëdhjetë) pikë**.

C. Kualifikim shtesë profesional - (10) pikë

- a. Përvoja dhe cilësia profesionale e posaçme për rolin dhe funksionet e inspektorit pranë ILD-së - (7) pikë**

45. Rezultatet profesionale në lidhje me këtë kriter vlerësimi, shqyrtohen nga Komiteti për të vlerësuar veçanërisht rëndësinë dhe dobinë e profilizimit dhe specializimit të arritur në përvojat e veçanta profesionale të kandidatit të cilat tregojnë vlera të spikatura profesionale në shërbim të drejtimit, organizimit dhe funksionimit të inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe të ushtrimit të kompetencave të këtij institucioni, përfshirë këtu vlerësimin e njohurive të posaçme profesionale në lidhje me ushtrimin e kompetencave të kontrollit. inspektive, hetimeve disiplinore si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji.
46. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varësi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 10 pikësh për këtë kategori vlerësimi, Komiteti, vlerëson deri në 7 pikë ekspertizën në fushat e së drejtës dhe posaçërisht në çështjet e drejtimit, organizimit dhe funksionimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si dhe ushtrimit të kompetencave me natyrë kontrolli, inspektimi, hetimi disiplinor si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji. Gjithashtu, Komiteti vlerëson deri në 3 pikë angazhimet profesionale shtesë të kandidatëve. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Komiteti mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara urdhrin nr. 7 (si më sipër) të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve.
47. Veprimtaria profesionale që kandidati znj. Etmonda Hoxha ka përmbushur si sekretar gjyqësor në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Elbasan, jurist në I.E.V.P Peqin, përfaqësuese dhe mbrojtëse e të drejtave dhe lirive të subjekteve të së drejtës (qytetarë/persona juridikë) në sektorin privat, specialiste në trajtimin paraprak të ankesave në ish KLD, si dhe sekretar gjyqësor pranë anëtarëve të komisioneve në KPK, është një veprimtari që ka lidhje me rolin dhe veprimtarinë e Inspektorit të lartë të Drejtësisë.
48. Lidhur me këtë kriter, Komiteti pasi shqyrtoi dokumentet profesionale të depozituara në dosjen e kandidimit dhe të analizuar më sipër lidhur me rëndësinë që ato mbartin, të dhënat e jetëshkrimit, si dhe intervistën e zhvilluar dhe motivimin për kandidim, Komiteti i emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve për kriterin e “Përvojës dhe cilësisë profesionale që a ka ushtruar në raport me rolin dhe funksionet e inspektorit pranë ILD-së”, e vlerëson kandidatin znj. Etmonda Hoxha me **3 (tre) pikë**.

b. Angazhime profesionale shtesë - (3) pikë

49. Nga aktet e dosjes dhe nga vetëdeklarimet e kandidatit Etmonda Hoxha, rezulton se ka paraqitur angazhime shtesë profesionale, krahas atyre që janë përmendur në këtë vendim dhe që lidhen me fitimin e titujve të tjerë profesionale, karahas atij të “juristit”, dhe konkretisht.

50. Tituj profesional

• Periudha : viti 2018

Lloji i titullit/ fusha profesionale : Leje ushtrimi profesioni të “Avokatit”, licencë nr. 9971.
Emri dhe lloji i institucionit që ka dhënë titullin : Dhoma Kombëtare e Avokatisë së Shqipërisë.

• Periudha: Korrik 2010

Datë 27.12.2012, vendimi nr. 122 dhënie licencë e **Ndërmjetësit** Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve , Strukturë brenda Ministrisë së Drejtësisë.

• Periudha: 2016

Prezantimi i platformës me temë “Roli i Avokatit të Popullit/mbi pozicionin e punës Komisioner i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës-punuar, me pjesëmarrës nga Shoqëria Civile, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.

• Periudha: tetor 2011- korrik 2012:

Lloji i titullit/ fusha profesionale : Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik
Emri dhe lloji i institucionit që ka dhënë titullin : Njësia Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, pranë Ministrisë së Financave.

51. Për këtë arsye Komiteti i emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve për kriterin vlerësues të “Angazhimeve profesionale shtesë”, Komiteti e vlerëson kandidatin me 2 (dy) pikë.
52. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë merita profesionale dhe kualifikim shtesë profesional, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me 5 (pesë) pikë.

2. MERITA MORALE, ORGANIZATIVE, DREJTUESE DHE MENAXHERIALE - (50) pikë

2/1. Merita morale - (25) pikë

53. Si kriter vlerësimi është përcaktuar që kandidatët të jenë vlerësuar për integritet të lartë moral dhe profesional. Konkretisht përcaktohen si kriterë vlerësimi edhe "*Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegeve*" dhe “cilësi morale të tilla si: Ndershmëria, përpikëria, drejtësia në marrjen e vendimeve dhe ushtrimin e detyrave” si edhe "angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”.
54. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 25 pikësh për të tre komponentët vlerësues, Komiteti vlerëson deri në 15 pikë integritetin etik dhe moral, deri në

8 pikë reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve dhe deri në 2 pikë angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

55. Në rastin e kandidatit, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes parashtrimeve në intervistë, motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Komitetin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës. Komiteti shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave morale të këtij kandidati.

a. Integriteti etik e moral - (15) pikë

56. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, integritetit etik e moral, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se kandidati në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e tij tregon përkushtim dhe angazhim të ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrave profesionale dhe në ushtrimin e profesionit, si edhe vëmendje, ndjeshmëri dhe respekt në komunikim e bisedë, duke parashtruar argumentet e tij me kompetencë, dinjitet, duke dëgjuar dhe përgjigjur me kujdesin e duhur, me durim e vetëpërbajtje përkundrejt qëndrimeve dhe pyetjeve të cilat i drejtohen nga bashkëbiseduesit.

57. Nga të dhënat e mundshme në dispozicion, Komitetit nuk i rezulton që kandidati të ushtrojë apo të ketë ushtruar funksionet e tij profesionale duke favorizuar palë të caktuara apo duke kërkuar përfitime për veten apo për të tjerët. Nuk rezultojnë të dhëna që ky kandidat të mos ketë respektuar detyrimin profesional të nderit dhe të dinjitetit, të ndërtimit të marrëdhënieve profesionale dhe mirësjelljes në raport me koleget, profesionistët e fushës, palët e përfshira në çështje pune etj. Pra nuk ka të dhëna që me sjelljen dhe veprimtarinë e tij në jetën profesionale dhe personale të ketë cenuar apo të rrezikojë të cenojë imazhin dhe figurën publike të nëpunësit shtetëror dhe sistemit të drejtësisë.

58. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të "*integritetit etik e moral*", Komiteti e vlerëson kandidatin me **15 (pesëmbëdhjetë) pikë**.

a. Reputacioni në shoqëri dhe midis kolegëve - (8) pikë

59. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve", nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim. Intervista,

komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se kandidati me veprimtarinë dhe sjelljen në shoqëri, tregon angazhim dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave për zbatimin e drejtë të ligjit në ushtrimin e kompetencave që i ngarkon ligji.

60. Në lidhje me vlerësimin e punës dhe reputacionin që kandidati znj. Etmonda Hoxha gëzon, rezulton se pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kandidati ka dorëzuar Letër Referencë nr. 7139 prot., datë 20.10.2021 lëshuar nga z. Edmond Vercani, Sekretar i Përgjithshëm i KPK-së, Rekomandim nr. ekstra Prot, datë 03.11.2017 lëshuar nga znj. Orjeta Myzeqari, drejtori i ALUIZNI, Tiranë 2, Rekomandim lëshuar nga znj. Shpresa Kekzi, Drejtore Ekonomike dhe e Menaxhimit të Fondeve pranë ish KLD-së, Certifikatë e sigurimit të personelit kategoria “Tepër Sekret”, të lëshuara nga drejtueset e organeve punëdhënëse ku ka shërbyer kandidati që venë në dukje cilësitë e saja etiko-profesionale.
61. Prandaj, duke konstatuar se me sjelljen dhe veprimtarinë e tij përmbush të gjitha pritshmëritë e aspektit moral për marrjen e përgjegjësive ligjore dhe institucionale, si edhe pritshmërinë e publikut për gëzimin e cilësive profesionale e morale për ushtrimin e detyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me kriterin vlerësues “të reputacionit që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **7 (shtatë) pikë**.

b. Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile - (2) pikë

62. Për sa i përket kriterit të vlerësimit që lidhet me angazhimin në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Komitetin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Komitetit i rezulton se, përgjithësisht, kandidati ka qenë pjesërisht për një periudhë kohe i angazhuar në veprimtari të tjera të përshtatshme jashtë atyre të lidhura me ushtrimin e detyrës ose të profesionit për ndjekje të kauzave të shoqërisë civile. Nga të dhënat e pasqyruara në CV, rezulton se gjatë periudhës **2013-2016, juriste, anëtare e skuadrës PRO-BONO, pranë Qendrës Ligjore, Qytetare**, kandidati znj. Etmonda Hoxha ka asistuar duke dhënë shërbim ligjor falas për individë në nevojë, si dhe ka monitoruar seancat gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe gjykata të tjera, ka analizuar përmbajtjen e vendimeve gjyqësore të dhëna, ka përgatitur raporte monitoruese si dhe ka marrë pjesën në aktivitete të tjera promovuese të Qendrës.

Periudha:2016

Prezantimi i platformës me temë “ Roli i Avokatit të Popullit / mbi pozicionin e punës Komisioner i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës-punuar dhe prezantuar nga

unë përpara një Komsioni përzgjedhës me pjesëmarrës nga Shoqëria Civile, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.

63. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “**Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile**”, Komiteti e vlerëson kandidatin me **1 (një) pikë**.
64. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë e meritave morale, rezulton se kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **23 (njëzetetë) pikë**.

2/2. Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale - (25) pikë

65. Ky komponent zërthehet në disa nën komponentë të tjerë, konkretisht:

- a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin;
- b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
- c) aftësitë e komunikimit;
- d) aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;
- dh) aftësitë e përfaqësimit publik."

66. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kriterë vlerësimi, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” ku përcaktohen rregullime me të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kriterëve.

67. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 25 pikësh për të pesë komponentët vlerësues të sipërcituar, Komiteti vlerëson deri në 8 pikë cilësinë e platformës dhe vizionin që paraqesin kandidatet, deri në 10 pikë aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore, deri në 5 pikë aftësisë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik, si edhe me 2 pikë për aftësitë e të punuarit në grup dhe ambiente multidisiplinore.

68. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij, Komiteti mban parasysht rregullat e hollësishme të përcaktuara me urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” dhe Shtojcën nr. 2 të tij si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të

merituara sipas metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidateve për inspektor.

69. Komiteti shqyrtoi përmbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës dhe arsyet apo motivet e kandidimit dhe vizionit të kandidatit lidhur me qasjen dhe qëndrimet e tij mbi rëndësinë dhe aspektet thelbësore të ushtrimit të detyrës së Inspektorit, mbi sfidat kryesore me të cilat duhet të përballlet Inspektori i Lartë i Drejtësisë në ushtrimin e përgjegjësive dhe kompetencave që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji, si edhe lidhur me mendimet e kandidatit për çështjet që duhet të trajtohen me përparësi e në perspektivë për mirë organizimin dhe mirëfunksionimin e këtij institucioni të ri dhe shumë të rëndësishëm kushtetues, për ushtrimin efektiv dhe me nivel të lartë profesional e besueshmërie të kompetencave të tij në funksion të ndërtimit të një sistemi drejtësie të bazuar në integritetin profesional e moral, nisur edhe nga pritshmëritë e jashtëzakonshme të publikut pas miratimit dhe vënies në zbatim të reformës në drejtësi. Gjithashtu, në vlerësimin e këtij kriteri, Komiteti mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhëna nga ky kandidat gjatë intervistës dhe në përgjigje të pyetjeve që iu drejtuan nga anëtarët e Komitetit.

a. Cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqet kandidati - (8) pikë.

70. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjatë intervistës, Komiteti vëren se kandidati ka depozituar në dosjen e kandidimit Letër Motivimi dhe jo Platformë (*sikurse kërkohet në bazë të kriterëve të vlerësimit, në kuptimin formalo-juridik*) në lidhje me veprimtarinë që përmbush ILD si. Megjithatë, nisura nga përmbajtja e Letrës të Motivimit të depozituar në dosjen e kandidimit si dhe intervistën e zhvilluar dhe motivimin për kandidim, Komiteti i emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, konstaton faktin se kandidati znj. Etmonda Hoxha paraqiti një nivel mesatar të njohjes dhe përvojës profesionale së saj në lidhje me rolin dhe pritshmëritë për ushtrimin e funksionit të inspektorit jomagjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, objektivat për çështjet e organizimit dhe funksionimit cilësor dhe efektiv të institucionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
71. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “Cilësia e platformës dhe vizionit të paraqitur” nga kandidatet, Komiteti e vlerëson kandidatin me **4 (katër) pikë**.

b. Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, bazuar në përvojat e mëparshme profesionale shoqërore - (10) pikë

72. Lidhur me aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, Komiteti mbështetet pikësëpari në të dhënat që lidhen me përvoja konkrete nga karriera e kandidateve në funksione dhe pozicione të cilat kërkojnë dhe tregojnë marrjen përsipër të përgjegjësive dhe ushtrimin e

vendimmarrjes në përmbushjen e kompetencave dhe të detyrave të ngarkuara, veçanërisht për aspektet e drejtimit dhe të administrimit të punëve. Në këtë drejtim. Komiteti shqyrton dhe vlerëson posaçërisht aftësitë e provuara ose premtuese për të marrë nisma, për të kërkuar zgjidhje, për të marrë përgjegjësitë si edhe për të marrë në vendimet e duhura e në kohën e duhur sipas përcaktimeve të ligjit dhe në përgjigje të ndjeshmërisë së publikut.

73. Në rastin e kandidatit, krahas jetëshkrimit, parashtrimeve dhe bisedës në interviste, përmbajtjes së platformës dhe motivimit për kandidim, Komiteti shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit. Për të evidentuar të dhëna në lidhje me aftësitë e provuara apo premtuese të këtij kandidati për të marrë vendime dhe përgjegjësi, në lidhje me funksionet dhe detyrat që ajo ka përmbushur më parapara në karrierën e saj, si dhe ushtrimin e funksionit të inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
74. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore”, Komiteti e vlerëson kandidatin **5 (pesë) pikë**.

c. Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik - (5) pikë

75. Aftësitë e komunikimit, në të gjitha format, veçanërisht me nëpunësit dhe punonjësit e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me organet e tjera të qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe përfaqësuesit e tyre, me gjyqtarët dhe prokurorët, sikurse edhe në komunikimin dhe përfaqësimin publik e me të tretët, të shprehurit në mënyrë të qartë, lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jo diskriminuese, luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
76. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim të platformës, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë si edhe nga përmbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit të dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Komiteti vëren se kandidati zotëron aftësi të mjaftueshme për të komunikuar me maturi, për të dëgjuar me respekt dhe për t’u përgjigjur me profesionalizëm, qartësi e thjeshtësi, me stil dhe gjuhë të pasur në lidhje me të gjitha çështjet dhe problematikat që vlerëson të trajtohen, ashtu edhe për çështje dhe problematika që ngrihen nga të tjerët.
77. Gjithashtu referuar prezantimit të bërë gjatë intervistës, rezulton se ky kandidat zotëron edhe aftësi të mira për përfaqësimin publik, prezanton thjeshtësi, aftësi për të shprehur bindjet e tij

me vetëbesim. Kandidati transmeton besueshmëri gjatë komunikimit dhe aftësi për t'u përgjigjur me etikë.

78. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të "Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik", Komiteti e vlerëson kandidatin me **4 (katër) pikë**.

d. Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore - (2) pikë

79. Inspektori për vetë natyrën e këtij institucioni dhe funksioni, duhet të zotëroje aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të organizuar dhe për të qenë i përfshirë në punën në grup, me nëpunësit dhe punonjës të Zyrës dhe për aq sa kërkohet dhe nevojitet me funksionarë e përfaqësues të institucioneve të tjera dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Pjesë e kësaj aftësie është edhe nevoja për tu përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës për t'u përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturale dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.

80. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dosjen e kandidatit, Komiteti vëren se kandidati zotëron aftësitë e duhura për të punuar në grup, përfshirë atë për të punuar në ambiente multikulturale dhe multidisiplinore.

81. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues "Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale", Komiteti vlerëson t'i caktojë kandidatit **2 (dy) pikë**.

82. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe kriterëve në kategorinë e meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale, kandidati vlerësohet të total nga Komiteti me **15 (pesëmbëdhjetë) pikë**.

III - Vlerësimi përfundimtar i kandidatit

Në përfundim të arsytimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar me sipër në këtë vendim, në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së Inspektorit jomagjistrat dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për këtë vend vakant, Komitetit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve i rezulton se kandidati Etmonda Hoxha vlerësohet në total me **62 (gjashtëdhjetëdy) pikë**.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrit nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve:

VENDOSI:

1. Vlerësimin e kandidatit Etmonda Hoxha, me **62 (gjashtëdhjetëdy) pikë**, në lidhje me kandidimin e tij për vendin vakant inspektor jomagjistrat, të shpallur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në datën 30.09.2021.
2. Ky vendim i njoftohet kandidatit Etmonda Hoxha.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në pjesën e përcaktuar për “Rekrutim Inspektor Jo magjistrat”.

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE

ANËTAR


Julian Zonja

KRYETAR


Besnik Maho

ANËTAR


Joana Asimi

